

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
Zyra e Edukimit të Fëmijërisë së Herëshme



Head Start: Edukon – Paşuron - Fuqizon

BULETIN INFORMATIV PËR FAMILJEN



NGA ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV

Joy Difehn

Mirësevini në Programin “Head Start” të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias! Ne shpresojmë për një vit të frytshëm dhe emocionues për fëmijët dhe familjet tona. Familjet luajnë një rol kryesor në përgatitjen dhe gatishmërinë e fëmijëve të tyre për vit të suksesshëm mësimor, dhe programi “Head Start” është një partner i vlefshëm bashkë me familjet në këto përpjekje.

“Head Start” ofron një program gjithëpërfshirës në një mjedis të sigurtë, edukues dhe të shëndetshëm. Fëmijët janë të përfshirë në veprimtari, e cila i ndihmon ata të rriten mendërisht, nga ana sociale, emocionale dhe fizikisht. Si prindër ju jeni mësuesit dhe parë dhe më rëndësishëm dhe ne realisht kemi nevojë për ju, të punoni me ne, të ndikoni pozitivisht në zhvillimin dhe mësimin e fëmijës tuaj.

Ky Buletin Informativ për Prindin është projektuar të ofrojë informacion për familjet e “Head Start” rreth shërbimeve, politikave dhe procedurave të programit. Ju lutemi, gjeni një kohë të familjarizoheni me programin tonë dhe përdoreni këtë buletin si një referencë të shpejtë, gjatë gjithë vitit.

MIRËSEVINI
NË
FAMILJEN PARASHKOLLORE “HEAD START”

Zyra Qendrore: 440 North Broad Street, Suite 170, Philadelphia, PA 19130

www.philasd.org

Tel. i Zyrës Qendrore: 215-400-4270 Website:

Zëvendës Kryetare (Deputy Chief) – **Diane Castelbuono**

Drejtor Ekzekutiv për “Head Start” (Executive Director Prekindergarten Head Start) – **Joy Diljohn**

Drejtor Ekzekutiv për Edukimin e Hershëm; Bashkëpunimet e Kujdesit të Fëmijës (Executive Director Early Childhood Education Child Care Partnerships) – **Michelle Linder-Coates**

Emri i Shkollës-Qendrës “Head Start”: _____

Vendi: _____ Numri i Klasës së Fëmijës: _____

Oraret e Qendrës

Qendrat janë të hapura nga E Hëna deri të Premten. Orët e shërbimeve janë: _____

Ditët e Premte sesioni zhvillohet gjysëm dite në mëngjes -AM. Mësuesit i planifikojnë pasdite –PM-leksionet e tyre dhe përgatitjen e materialeve për javën e ardhëshme. **Të gjitha qendrat parashkollore “Head Start” ndjekin kalendarin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, për ditët e festave dhe rastet e tjera të mbylljes së shkollave.**

Emri i Drejtorit: _____ Telefoni i Shkollës: _____

Emri i Mësuesit të Fëmijës: _____ Dhoma # _____

Emri i Asistentit të Mësuesit: _____

Koordinatori i Edukimit : _____ E-Mail _____

Specialisti i Mësimdhënies: _____ E-Mail _____

Punonjësi Social: _____ E-Mail _____

Përfaqësuesi i Shërbimit në Familje: _____ E-Mail _____

Infermiera: _____ E-Mail _____

Koordinatori i Nevojave Speciale: _____ E-Mail _____

Përfaqësuesi i Ushqyerjes: _____ E-Mail _____

Asistenti për Përfshirjen e Prindit: _____ E-Mail _____

Konsulenti i Shëndetit Mendor: _____ E-Mail _____

TABELA E PËRMBAJTJES

MESAZH NGA ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV	1
QENDRA E MIRËSEARDHJES DHE PERSONELI MBËSHTETËS	2
UDHËHEQËSIA E PROGRAMIT	4
MISIONI I PROGRAMIT DHE DEKLARATA E VIZIONIT	5 - 6
POLITIKAT DHE PROÇEDURAT E PERGJITHËSHME TË PROGRAMIT	7-9
POLITIKAT DHE PROÇEDURAT PËR USHQYERJEN DHE SHËRBIMIN E USHQIMIT	10-11
POLITIKAT DHE PROÇEDURAT E SHËRBIMIT TË SHËNDETIT	12-13
GATISHMËRIA PËR SHKOLLË	14-15
PROÇEDURAT NË RASTE URGJENCE	16-17
PËRFSHIRJA E PRINDIT DHE FAMILJES	18-19
POLITIKA DHE KËRKESAT E VULLNETARIZMIT	20-21
IDE PËR PRINDËRIT DHE FAMILJEN VULLNETARE	22
UDHËZIME TË VLEFSHME PËR VULLNETARËT – ÇFARËDUHET DHE ÇFARË S’DUHET	23
ATËSIA DHE NISMA PËR PËRFSHIRJEN E MESHKUJVE	24-25
MUNDËSI PUNËSIMI PËR FAMILJET E “HEAD START”	26-27
BRENDA FAQES SE FUNDIT – PËRSHKRIMI I FOTOVE NË FAQEN E PARË	



UDHEHEQJA E PROGRAMIT

Drejtori Ekzekutiv i Programit

Menaxher i Programit - Operacionet

Menaxher i Programit - Konsumi

Personeli Administrativ

Koordinatorët e Edukimit në Terren

Koordinatorët e Shërbimit Shëndetesor

Koordinatorët e Ushqyerjes

Koordinatorët e Përfshirjes së Prindit

Punonjësi Social dhe Supervizori i Trajnimit

Burimet e Fondeve

Programi parashkollor “Head Start” financohet plotësisht nga Departamenti i Shëndetit, Administrata e Shërbimeve Njerëzore për Fëmijët dhe Familjet dhe Zyra e Shtetit të Pensilvanisë për Zhvillimin dhe Mësimin e Fëmijës.

Kapaciteti i programit tonë është **6,599** fëmijë, që financohen nga grante federale, nga “Pennsylvania Head Start State Supplemental grant” dhe fonde shtesë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias për “Title I”.

Drejtoria Arsimore e Filadelfias, si përfituese e fondeve, ofron shërbime gjithëpërfshirëse në shkolla për fëmijët dhe familjet. Në vazhdim, Drejtoria bashkëvepron, për këto shërbime, me **34** agjensi të kujdesit të fëmijëve dhe nga komuniteti

Deklarata e Misionit

Programi parashkollor “Head Start” i shërben fëmijëve dhe familjeve që kualifikohen në Qytetin e Filadelfias, duke ofruar një varg shërbimesh të detyruara, që janë konceptuar për nxitjen, përfshirjen dhe mbështetjen e çdo fëmije dhe familjeve, për arritjen e maksimumit të potencialit të tyre. Duke punuar si partnerë me familjet, programi “Head Start” përdor një qasje në ekip, që integron:

- 📚 Edukim parashkollor të zhvillimit gjithëpërfshirës, për fëmijët e pranuar, duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta
- 📚 Shërbime shëndetësore, të ushqyerjes dhe sociale, me fokus tek familjet
- 📚 Mundësi për përfshirjen dhe edukimin e prindit
- 📚 Vullnetarizëm nga prindërit dhe komuniteti

Ne e kuptojmë, që për ofrimin e këtyre shërbimeve ndërvepruese, ne duhet të përdorim një qasje ekipore brënda programit dhe komunitetit, të përbërë nga avokatë të fëmijëve dhe familjeve.

Ne njohim faktin që prindërit gjatë gjithë jetës, janë edukatorët kryesorë të fëmijëve të tyre dhe besojmë se nëpërmjet edukimit të tyre fuqizojmë familjet.

Deklarata e Vizionit



**HEAD START:
EDUKON
PASURON
FUQIZON**

Vizioni realizohet duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse në fushat e mëposhtme të përmbajtjes



HARTIMI I PROGRAMIT DHE MENAXIMI

- Qeverisja e Programit
- Sistemet e Menaxhimit



ZHVILLIMI I FEMIJES – GATISHMERIA PER SHKOLLE

Shëndeti dhe Ushqyerja

- Zhvillimi i Fëmijës
- Vlerësimi dhe Rezultatet e Fëmijës
- Kontrolli i Shikimit dhe Dëgjimit
- Shërbimi dhe Edukimi i Ushqyerjes
- Mirëqenia dhe Edukimi Mental
- Shërbime për Paaftësinë & Speciale
- Edukimi Shëndetësor dhe Burimet



PRINDI, FAMILJA DHE PERFSHIRJA E KOMUNITETIT

- Përfshirja e Familjes
- Përfshirja dhe Angazhimi i Prindit
- Angazhimi i Komunitetit

Politikat dhe Proçedurat e Programit

Procedura e Frekuentimit me Nivele

CELËSI

ASM – Takimi për Frekuentimin (Attendance Support Meeting)

COPA – Administrimi i Planifikimit të Rezultateve të Fëmijës (Child Outcome Planning Administration)

EFA – Administratori i Edukimit (Education Field Administrator)

FSFR – Përfaqësuesi i Shërbimit në Familje (Family Service Field Rep)

Niveli Katër

Ndërhyrja

Niveli Tre

Strategjitë

Niveli Dy

Parandalimi

Niveli Një

Promovimi

NIVELI KATER -NDËRHYRJA

- Familja vazhdon mungesat pa arsye (mjekësore, situata të tranzicionit, etj.)
- Familjes do t'i dërgohet letër nga FSFR, ku kërkohet një takim për mungesat/ caktuar me Punonjës Social – Të gjitha fushat, që janë të nevojshme dhe të dokumentuara
- Familjes që nuk ndjekin ASM do të vendosen në listën e pritjes dhe do dokumentohen
- FSFR do të plotësojnë formularin e largimit/transferimit
- Mësuesi do të njoftohet rreth familjes
- Të dhënat e frekuentimit monitorohen çdo javë në COPA

NIVELI TRE - STRATEGJITË

- Familja arrin 5-10 ditë mungesash (FSFR do të kontaktojë familjet me telefon) dhe do t'i dokumentojë.
- Letër për familjet për mungesa 5-10 ditë, Letra do të dërgohet nga FSFR ku do të kërkohet takim me FSFR/Punonjës Social për asistimin e familjes dhe ofrimin e burimeve komunitare/ose lidhjen e familjeve me nevojat (p.sh Infermier, Specialist Ushqyerje) dhe dokumentim
- Familjet që nuk kontaktojnë FSFR për caktimin e takimit FSFR/ Punonjësi Social, do të vizitohet shtëpinë dhe dokumentojë
- Të dhënat e frekuentimit monitorohen çdo javë në COPA

NIVELI DY - PARANDALIMIMI

- (3) ditë mungesa....Mësuesit kontaktojnë familjet për arsyet e mungesave
- FSFR kontrollon çdo ditë librin e frekuentimit/COPA
- 3-5 ditë mungesa, letër për familjet/FSFR për t'i kujtuar familjeve rreth frekuentimit dhe dokumentit
- Personi i të dhënave /FSFR do të njoftojë EFA për mësuesit,që nuk bëjnë apelin çdo ditë. Të dhënat e frekuentimit monitorohen çdo javë.

NIVELI NJE - PROMOVIMI

- Familjet marrin politikat dhe procedurat e frekuentimit
- Mësuesit marrin mungesat brënda 1 ore të hapjes së qendrës
- Mësuesit kontaktojnë ato familje që raportojnë në shkollë/dhe dokumentojnë në COPA
- Mësuesi plotëson COPA deri në 10:00 am
- Personi i të dhënave kontakton mësuesit që s'kanë dorëzuar frekuentimin. Përqindja e frekuentimit monitorohet çdo javë.
- EFA do të komunikojë me qëndrat, që janë nën 85%
- FSFR do të publikojë përqindjen e frekuentimit në vendin e caktuar
- Festa për klasat që veprojnë mirë
- Festa për prindërit që sjellin fëmijët në shkollë

POLITIKAT DHE PROCEDURAT E PROGRAMIT

Frekuentimi

Frekuentimi i rregullt është i rëndësishëm për zhvillimin fëmijës tuaj në përvojën e parashkollorit dhe gatishmëinë për klasën e kopështit. Ju lutemi njoftoni mësuesin e fëmijës tuaj, nëse fëmija juaj do të mungojë.

Përmbajuni politikës së mëposhtme të frekuentimit:

- Nëse fëmija duhet të mungojë, prindi/kujdestari duhet të njoftojë brenda një ore nga hapja e qendrës.
- Nëse fëmija mungon tre (3) ditë rresht, si i sëmurë, duhet të paraqitet raporti nga mjeku, kur të rikthehet.
- Ardhja e shpeshtë me vonesë, frenon mësimin dhe zhvillimin e fëmijës, dhe shqetëson përvojën mësimore të shokëve të tij.

Standardet e Performancës të Programit “Head Start” theksojnë se fëmija që vjen vazhdimisht me vonesë mund të largohet nga programi dhe të zëvendësohet me fëmijë tjetër në listën e pritjes.

Mungesat: Mësuesi do të telefonojë brenda një ore nga koha e ardhjes, nëse fëmija nuk është prezent dhe familja nuk ka telefonuar për mungesë

- Nëse fëmija mungon 3, ose më shumë ditë, kërkohet një shënim nga doktori.
- **5-10 Mungesa:** Personeli i Shërbimit në Familje do të takohet me prindin/kujdestarin për diskutimin e mungesave dhe strategjitë për mbështetjen e

familjes në këtë rast. (Shih nivelin e mungesave për procedurat specifike)

Shoqëruesit – Ardhja dhe Largimi

- Prindi/kujdestari, ose i caktuari prej tyre (mbi moshën 18 vjeç), **DUHET** të shoqërojë fëmijën në vajtje dhe ardhje nga qendra “Head Start”. Për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijës, veproni sipas udhëzimeve të mëposhtme:
- **Të gjithë shoqëruesit (prindërit/të tjerët) duhet të kenë një foto I.D të vlefshme (p.sh patentë, ID e Punëdhënësit, ID e Shkollës, ID e Shtetit, etj.) Një kopje e tyre do të ruhet në dosje.**
- Fëmijët duhet të futen dhe të dalin nëpër një zonë të caktuar.
- Shoqëruesit në ardhje duhet të firmosin emrin e plotë në regjistër çdo ditë dhe të shënojnë një numër kontakti.
- Shoqëruesit në marrjen e fëmijës duhet të firmosin emrin e plotë dhe të shënojnë orën e marrjes.
- Fëmijët do të lejohet të merren vetëm nga personat e caktuar si shoqërues.
- Në raste urgjencash, si përjashtim për një ditë, me lejen telefonike të prindit/kujdestarit fëmija mund të merret nga dikush që nuk e ka emrin në listë.
- Fëmija nuk do të lejohet të merret nga dikush, që nuk është familjar me ta.

Ardhja me Vonesë

Fëmija duhet të vijë dhe të largohet nga qendra çdo ditë në kohën e përcaktuar.

- Ardhjet dhe largimet me vonesë ,që përsëriten, do të kërkojnë një takim me personelin e shërbimit familjar.
- Nëse ju jeni me vonesë në marrjen e fëmijës, jashtë orarit, fëmija do të rrijë në godinë me një nga personeli, ose në drejtori.
- Në raste se nuk mundësohet komunikimi për marrjen e fëmijës, fëmija mund të konsiderohet i braktisur dhe mund të kontaktohen Shërbimet Mbrojtëse të Fëmijës (Child Protective Services) (DHS) për marrjen e fëmijës.

Kontaktet në Raste Urgjencash

Mund të jetë e nevojshme që gjatë ditës të kontaktohet prindi/kujdestari për shkak të gjendjes së fëmijës. Kështu që ne kerkojmë të mbani të saktë informacionin e kontaktit për rast urgjence, si adresën, numrat e telefonit deh dy emra personash. Këta persona duhet te jenë te gatshëm për marrjen e fëmijës në një rast të paparashikuar dhe ku ju nuk mund të kontaktoheni. Ju lutemi informoni keta persona, që ju i keni dhënë emrat/numrat e tyre në personelin e qendrës.

Kujdestaria/Urdhër Ndalimi

Kujdestaria, ose urdhëri i ndalimit duhet të paraqitet bashkë me aplikimin për shërbimet “Head Start”. Dokumentat do të mbahen në rekordet e fëmijës/familjes, në shkollë. Çdo ndryshim i mundshëm duhet të paraqitet te personeli, që të garantohet siguria e fëmijës tuaj.

Paketa e Kujdesit të “Head Start”

- Një palë veshje shtese, përfshirë çorape dhe mbathje
- Një batanije e vogël
- Një çarçaf i vogël
- Një qese që mbyllet për ruajtjen e rrobave
- Një qese plastike për rrobat e ndotura

Ju lutemi vendosni emrin e fëmijës në çdo artikull me një marker që nuk fshihet. Merrni në shtëpi çdo fundjavë rrobat e ndotura për larje.

Kodi i Veshjes

Drejtorja Arsimore e Filadelfias ka një kod veshje. Në mënyrë që të jeni korrekt me këtë politikë, kontrolloni për ngjyrat e shkollës duke telefonuar Zyrën e Përfshirjes së Prindit, Familjes dhe Komunitetit , në Drejtorinë Arsimore me numër: 215-400-4180. Ose në uebsajt: www.philasd.org në linkun “families link”

Rrobat dhe Pajimet e tjera

Fëmija juaj duhet të vishet që të ndjehet rehat, të ketë rroba që lahen, që lejojnë pepjesëmarrje në veprimtaritë e programit. Këpucët dhe çorapet mbahen veshur gjithmonë. Këpucët e hapura në majë, pantoflat, zbukurimet, rruazat dhe të tjera si këto nuk janë të sigurta dhe s’duhen veshur.

Disiplina – Menaxhimi i Sjelljes

Politikat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias dhe Programit Parashkollor “Head Start” ndalojnë çdo formë të ndëshkimeve trupore nga personeli, prindërit, ndërsa janë në mjediset shkollore, ose gjatë aktiviteteve dhe ngjarjeve të sponsorizuara.

Ligji i Shtetit për Pakujdesshmërinë dhe Abuzimin me Fëmijën

Të gjitha Drejtoritë Arsimore, Qëndrat e Kujdesit, Agjensitë e Kujdesit të Fëmijëve dhe profesionistët mjekësorë, janë të detyruar sipas ligjit të raportojnë çdo incident të dyshuar për abuzim, ose neglizhencë ndaj fëmijëve. Act 126

Përdorimi i gjuhës fyese, deklarimeve abuzive dhe kërcënimeve të çdolloj natyre për individët, është subjekt i veprimeve të rëndësishme.

Mbyllja për Shkak të Përkeqësimit të Motit

Kur konditat e motit e detyrojnë Drejtorinë Arsimore të mbyllë shkollat, kjo do të sjellë edhe mbylljen e qendrave Parashkollore “Head Start”. Postuar ne Uebsajtin e Drejtorisë.

Dëgjoni për mbylljen e shkollave në stacionin KYW Radio Station - 1060 AM ose në TV Lokal, Kanalet (Channels) 3, 6, 10 ose 29.

Siguria e Këmbësorëve

Informacioni jepet gjatë orientimit për të gjitha familjet, që kanë të bëjnë me transportin rrugor, makinë, kryqëzimet e rrugëve, dhe sigurinë në zonë. Kjo është një rregullore federale dhe kërkesë për programin “Head Start”.



Politikat dhe Procedurat

Ushqyerja & Shërbimet e Ushqimit



Politikat dhe Proçedurat e Programit

Ushqyerja dhe Shërbimi i Ushqimit

Koha e ngrënies është pjesë përbërëse e përvojës në “Head Start”. Të gjithë pjestarët e kësaj kohe **duhet** të ndjekin udhëzimet për sigurinë dhe higjenën e ushqimit.

- Çdonjëri që merret me ushqimin duhet të lajë duart më përpara se të veprojë.
- Të gjithë vullnetarët, prindërit/kujdestarët duhet të heqin palltot, kapelet , dorashkat dhe të lajnë duart, përpara se të ndihmojnë për ushqimin.
- Fëmijët duhet të lejohen të shërbejnë dhe të ushqehen vetë, si në një familje.
- Asistenca duhet të jepet për fëmijët me nevoja speciale, ose paaftësi.
- Asnjë ushqim, përfshirë edhe ai i pasdrekes, nuk mund të merret në shtëpi. I gjithë ushqimi duhet të shërbehet dhe konsumohet në qendër.

Programi ushqimor përfshin mëngjesin, drekën dhe një vakt pasdreke.

Mëngjesi (shërbehet midis 8:30 am – 9:15 am)

- Çdo fëmijë i ofrohet mëngjes, pasi ai/ajo arrin në klasë. Nëse një fëmijë ha mëngjes në shtëpi, ai/ajo mund të hajë edhe në qendër.
- Asnjë fëmijë nuk detyrohet për të ngrënë. Fëmijës i ofrohet ushqimi i plotë dhe është dëshira e tyre të hanë atë pjesë që duan.

Mëngjesi **nuk** mundësohet për personelin, prindërit dhe vllëzërit/motrat.

Dreka (shërbehet midis 11:30 am -12:45 pm)

- Në qendër shërbehet çdo ditë ushqim i ngrohtë.
- Fëmijët nxiten, por nuk detyrohen kurrë të hanë çdo gjë.
- Ushqimi nuk përdoret si trajtim, shpërblim, ose dënim.
- **Jo kikirikë!** Kikirikët, gjalpë i kikirikëve, aroret dhe ndonjë ushqim që përmban ndonjë prej këtyre përbërësve **nuk** shërbehet për fëmijët e qendrës. Ju lutemi informoni mësuesin e fëmijës, personelin e Shërbimit Shëndetësor dhe atë të Shërbimit të Ushqyerjes, për ndonjë alergji nga ushqimi.
- Dreka ofrohet edhe për personelin .
- Prindërit që janë vullnetarë në klasë gjatë mëngjesit, mund të hanë fëmijët, kur ka ushqim të tepërt. Ju lutemi asistoni fëmijët sipas nevojave dhe përfshihuni në një bashkëbisedim me ata që janë në tryezën tuaj.
- Personeli dhe vullnetarët nuk mund të hanë dhe pijnë ushqime të tjera ndërsa qëndrojnë me fëmijët.
- Prindërit/kujdestarët **nuk duhet** të sjellin nga jashtë asnjë ushqim, embëlsira ose të tjera në klasë. Përgjatë nga kjo politikë duhet vetëm me autorizimin e Koordinatorit të Ushqyerjes dhe Shëndetit

Për arsye të dokumentuara mjekësore, ose fetare.

Dreka shërbehet për të gjithë fëmijët dhe prindërit/kujdestarët, që janë në ekskursionë. Prindërit nuk duhet të marrin ushqime nga jashtë në ekskursionë. Mëngjesi do të shërbehet në qendër përpara nisjes për në ekskursion, dhe vakti i pasdrekes do të shërbehet kur fëmijët të kthehen nga udhëtimi.

- **Ushqimi i Pasdrekes** (shërbehet midis 2:15 pm – 2:45 pm) – Fëmijëve, çdo ditë, u shërbehet pasditeve një ushqim i lehtë. Ushqimi duhet të konsumohet në qendër dhe **nuk** mund të merret në shtëpi.
- ❓ Asnjërit nuk i lejohet të shërbejë ushqim të gatuar në shtëpi për fëmijët që janë në qendër. Kjo është si masë mbrojtëse ndaj alergjive dhe mbrojtja e sigurisë së shëndetit të tyre.
- ❓ Të gjitha pijet freskuese që shërbehen për fëmijët në festime, ose ngjarje të tjera, duhet të jenë të paketuara, pije dhe ushqime që të standardeve tregtare. Këto freskuese mund të shërbehen vetëm pasi të jetë shërbyer ushqimi i pasdites dhe nuk mund të zëvendësojnë asnjë prej vakteve të tjera ushqimore.

Politikat dhe Proçedurat

Shërbimet e Shëndetit

Programet “Head Start” ofrojnë shërbime, që mbështetin familjet dhe forcojnë komunitetin, të cilat nxitin shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve. Fokusi është në identifikimin e hershëm, trajtimin, promovimin e shëndetit dhe shkrim-këndimin, që janë pjesë e **Gatishmërisë për Shkollë**.

Shërbimet Ofrojnë:

- ☐ Shëndetin Mendor
- ☐ Kujdesin për Ushqyerjen
- ☐ Nevojat Speciale

KËRKESAT E “HEAD START”:

- **KËRKESAT E REJA PËR VAKSINIMET:**

Fëmijët që ndjekin grupe të kujdesit në shkollë, duhet të jenë në pajtim me kërkesat e imunizimeve, që kërkohen nga “28 Pa. Code § 27.77.” Këto kërkesa janë specifikisht për fëmijët nën moshën 5 vjeç, ku theksohet se **HYRJA** në shkollë, përfshirë nxënësit tanë para-shkollorë, duhet të ketë vaksinimet e mëposhtëme...

3 Hepatitis B
4 DTaP
3 IPV (POLIO)
1 MMR
1 VARICELLA (CHICKEN POX)

- * Nuk aplikohet për nxënësit në situata të përkohëshme banimi dhe/ose imigrantët
- ☐ Kontrolli Fizik: Kryhet në pranim & vjetore.
- ☐ Raporti Dentar: Kryhet në pranim & vjetore.

UDHËTIMET E SHKOLLËS & SHËNDETI

- ☐ Fëmija juaj NUK DO lejohet të ndjekë ndonjë prej udhëtimeve shkollorë PA patur Kontrollin Fizik, Programi i Kujdesit për Ushqimin për Fëmijët dhe të Rriturit, Formulari i Planit të Kujdesit Mjekësor.
- ☐ ****KJO NUK APLIKOHET PËR FAMILJET QË JANË NË SITUATË TË PËRKOHËSHME JETES****

Formulari DAKORTËSI PËR DHËNIE INFORMACIONI:

- ☐ E nevojshme për komunikimin me Doktorin, Dentistët dhe specialistët mjekësor
- ☐ Merret nga infermierët në pranim, në fillim të vitit shkollor.

MJEKIMET NË SHKOLLË:

- Njoftoni mësuesin e fëmijës nëse mjekimi duhet marrë gjatë orëve të programit “Head Start”.
- Ilaçet duhet të jenë në paketimin origjinal të farmacisë, DUHET të ketë etiketën e farmacisë me udhëzimin e përdorimit dhe emrin e fëmijës.
- ☐ Mësuesi do të njoftojë infermierin e caktuar në qendër.
- ☐ Infermieri do të bashkëpunojë me ju, për dokumentacionin që kërkohet.

HIGJENA DENTARE:

Ndërsa janë në qendër, fëmijët praktikojnë higjenë të mirë dentare.

- Çdo fëmijë do të përdorë furçen e tij/saj të dhëmbëve, që mbahet në një mbajtëse higjienike.
- Furça e dhëmbëve ndërrohet çdo tre muaj.
- Fëmija *do t’i* pastrojë çdo ditë dhëmbët nën kujdesin e personelit të qendrës.

GJENDJA SHENDETESORE & SEMUNDJET NGJITESE:

Nëse një piestar i personelit vëren se fëmija juaj duket sëmurë, ose ka simptoma të një sëmundje ngjitëse, indermieri, mësuesi, ose një pjestar tjetër i qendrës do t’ju telefonojë.

Fëmija mund të largohet përkohësisht nga lëndime afat shkurtër, sëmundje ngjitëse, ose arsye të tjera, që mund të ndikojnë në shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve të tjerë dhe/ose personave që mund të jenë në mjediset e qendrës.

NË RAST SE FËMIJA ESHTË LARGUAR NGA SHKOLLA, KËRKOHET NJË SHËNIM NGA MJEKU, OSE SPITALI QË TË RIKTHEHET PËRSËRI.

NDIQNI MJEKIMIN NË SËMUNDJE OSE LËNDIME SERIOZE:

SINJALIZONI MËSUESIN E FEMIJES, NESE...

- ☐ Fëmija është shtruar në spital
- ☐ Nëse fëmija ka shkuar në Urgjencën Spitalore ditën/mbrëmjen/fundjavën para se të vijë në shkollë.

JU DUHET TË SILLNI NJË JUSTIFIKIM NGA DOKTORI/SPITALI.

Infermieri i qendrës tuaj do të bashkëpunojë me ju dhe/ose mësuesin e fëmijës për shëndetin e fëmijës në shkollë.

MBAJENI FËMIJËN NË SHËTËPI, KUR:

- Ka një temperaturë mbi 100° (përfshirë atë të një nate më parë)
- Ka të vjella.
- Ka diarre.
- Ka një sëmundje ngjitëse (sy të skuqur, dhibje fyti, li, fruth, etj.).

Keni preokupim që lidhet me mireqenien e fëmijës?

- Diskutoni me mësuesin e fëmijës. Mësuesi do të referojë në personin e duhur të Ekipit Mbështetës të programit të Parashollorit/ Head Start.

BURIMET:

Qendra mësimore dhe Njohëse për Parashollorët “Head Start”

<https://eclkc.ohs.acf.hhs.gov/>

Kujdesimi për fëmijët tanë

<http://cfoc.nrckids.org/>

Burimet e Familjes të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias [https://www.philasd.org/resources-for-families-Philadelphia-Immunization-Requirements-for-School-Entry-\(2017/2018\)](https://www.philasd.org/resources-for-families-Philadelphia-Immunization-Requirements-for-School-Entry-(2017/2018))

<https://kids.phila.gov/index.php/resources/school-immunization-requirements/>



SYNIMET E GATISHMËRISË PËR SHKOLLË

Aftësitë e nevojshme, që fëmijët të jenë të suksesshëm në kopësht:

Sociale dhe Emocionale

1. Shpreh emocionet sipas situatës
2. I njeh pëlqimet dhe aftësitë e veta
3. Mund të ofrojë zgjidhje të thjeshta për konfliktin
4. Mund të ndjekë rregullat dhe rutinën

Gjuhësore

5. Njeh 10 shkronja të mëdha dhe 10 të vogla
6. Dallon emrin, ose fjalë të tjera në shtyp
7. Bën tingujt fillestarë në fjalë të shkurtëra
8. Përputh 6-10 shkronja me tingujt e tyre
9. Kujton detaje nga ndodhitë
10. Përdor kopertinën dhe vizatimet për të folur rreth librit
11. Shkruan me shumicën e shkronjave saktë emrin e vet

12. Planifikon dhe tregon, skicon, ose shkruan një ndodhi

13. Flet fjali të kuptueshme.

14. Përgjigjet saktë për drejtimet dhe pyetjet

15. Flet me shoket dhe familjarët e rritur

16. Bën pak gabime gramatike në të folur

Matematikë dhe Shkencë

17. Numëron deri në 20

18. Njeh numrate shkruar nga 1 deri 10

19. Kupton mbledhjet dhe zbritjet e thjeshta

20. Emërton katrorët, trekëndësat
rrathët, dhe katërkëndësat.

21. Përshkruan pozicionin ose rradhën e
sendeve (i pari, ai që pason)

22. Krahason dy objekte (më i madh, më i gjatë, më
i rëndë)

23. Klasifikon, mumëron dhe krahason sasitë

Qasjet në Mësim

24. Shfaq interes për përvojat e reja

25. Vepron në skenarë të njohur, jep dhe
merr role

26. Insiston në aktivitetet e zgjedhura, edhe
kur ato vështirësohen

27. E zbërthen detyrën në faza dhe vepron
me rradhë

Zhvillimi Fizik

28. Kërkon të zgjidhë problemet në

- rrugë të ndryshme, merr ndihmën e nevojshme

29. Përdor objekte të vegjël

30. Lëviz me vetëbesim të gjithë trupin

Këto 30 synime të gatishmërisë për në shkollë janë bazuar në "PA Office of Child Development and Early Learning (OCDEL) Kindergarten Entry Inventory".



GATISHMERIA PER SHKOLLE

Qasja e “Head Start” për Gatishmërinë në Shkollë do të thotë që fëmijët janë gati për shkollë, familjet janë gati të mbështetin fëmijët për mësim dhe shkollat janë gati për fëmijët.

VIZITAT NE SHTEPI

Vizitat në Shtëpi bëhen (2) herë në vit.

Personelit të klasës, bashkë me personelin tjetër mbështetës, i kërkohet që të bëjnë vizita në shtëpi gjatë vitit....

- a. Vizitat në shtëpi, nëse kerkohen, mund të bëhen në vende komunitare. Ata nuk kanë qëllim t’ju gjykojnë ju, ose familjen tuaj.
- b. Ndhmon ju dhe fëmijën tuaj që të përgatitet për mjedisin shkollor, ose parashkollor.

Në qendër mund të realizohen edhe takimet prind/mësues.

Gatishmëria për Shkollë

- Për diskutimin e çdo shqetësimi që lidhet me progresin e zhvillimit të fëmijës, ose të përvojës tuaj në “Head Start”.

AKTIVITETET KALIMTARE DHE MBESHTETJA

Këto aktivitete fokusohen në kalimin e fëmijës në programin tonë dhe tranzicionin për në kopësht, ose qendrat mësimore për edukimin e hershëm.

Aktivitetet e ofruara janë për:


- Dhënien e informacionit më të fundit për progresin e zhvillimit të fëmijës.

- Ndhmon ju dhe fëmijën tuaj që të përgatitet për një mjedis parashkollor, ose shkollor environment.
- Ofron informacionin përkatës për progresin e zhvillimit të fëmijës tuaj.

Fëmijët e mundshëm për klasat e kopështit (5 vjeç në , ose 1 Shtator të çdo viti) duhet të regjistrohen në shkollën e zonës.

Veprimtaritë kalimtare janë koordinuar me mësuesit e kopështit dhe të “Head Start”.

Do të ofrohen seminare dhe informacion për takimet dhe aktivitetet.



Proçedurat në Raste Urgjente



A. Evakuimi

(Përdoret kur konditat jashtë mjedisit janë mësigurta se brënda)

- Merni rrugën më të sigurtë të caktuar
- Asistoni ata që kanë nevojë
- Mos ndaloni për sendet e të tjerëve
- Shkoni në Zonën e caktuar të Grumbullimit
- Kontrolloni për lëndime
- Prisni për udhëzime të tjera

B. Evakuimi i Kundërt

(Përdoret kur konditat brënda mjedisit janë më sigurta se jashtë)

Kur bëhet njoftim, ose bie alarmi:

- Lëvizni me shpejtësi nxënësit dhe personelin brenda
- Asistoni ata që kanë nevojë
- Raportoni në klasë
- Kontrolloni për lëndime

C. Vend i Sigurtë për Mot të Keq

(Përdoret për urgjenca të motit)

Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Procedurat Universale në Raste Urgjencash

Kur bëhet njoftim, ose bie

alarmi:

- Merni rrugën më të sigurtë për në vendin e caktuar
- Nxënësit e klasave portative do të lëvizin në godinën kryesore në vendin e caktuar
- Asistoni ata që kanë nevojë
- Mos ndaloni për sendet e të tjerëve
- Mbyllni të gjitha dyert
- Qëndroni në vendin e sigurtë deri në njoftimin, që rreziku kaloi.(all clear)
- Prisni për udhëzime të tjera

D. Strehimi në Vendndodhje

(Përdoret në rastet ekstreme kur ka gaz, ose kimikate)

- Nxënësit largohen menjëherë nga korridoret dhe drejtohen në klasën më të afërt, ose vendin e caktuar
- Asistoni ata që kanë nevojë urgjente
- Mbylli dhe vulosni të gjitha dyert dhe dritaret, si fundin e derës(bllokon gazin/kimikatin nga jashtë)
- Asnjë nuk lejohet të dalë nga dhoma

- Qëndroni larg dyerve dhe dritareve
- Pritni për udhëzime
- I dërgoni nxënësit në muret e brendëshme
- Fikni dritat, RRINI TË QETË!!
- Prisni për udhëzime të tjera

Bllokimi

(Përdoret për mbrojtjen e banorëve të godinës nga rreziku potencial në godinë)

- Nxënësit largohen menjëherë nga korridoret dhe drejtohen në klasën më të afërt, ose vendin e caktuar
- Asistoni ata që kanë nevojë urgjente
- Mbyllni dhe kyçni të gjitha dyert dhe dritaret dhe mos dilni për asnjë arsye
- Mbuloni të gjitha dhomat, dyert, dritaret
- I dërgoni nxënësit në muret e brendëshme
- Fikni dritat, RRINI TË QETË!!
- Prisni për udhëzime të tjera

F. Shtrihuni(Drop), Mbuloni(Cover), Qëndroni (Hold)

(përdoret për rrezik të shpejtë në ndërtesë, ose në afërsi të ndërtesës)

Kur jepet komanda “Shtrihuni” (DROP):

- **SHTRIHUNI** – Në dysheme/tokë
- **MBULONI** – mbuloni sytë duke e lëvizur fytyrën drejt krahut
- **QENDRONI** – mbani vendin/ pozicionin që keni
- Asistoni ata që kanë nevojë urgjente
- I dërgoni nxënësit në muret e brendëshme dhe i shtrini në tokë

Angazhimi i Prindit, Familjes dhe Komunitetit



PNC Bank, United Way, PKHS Parent & Staff Community Service Day

Translation & Interpretation center (5/2018)

Parent Handbook (Albanian)

PROGRAM I PËRFSHIRJES DHE ANGAZHIMI I FAMILJES



Filozofia e “Head Start” është bazuar në kushtin paraprak, që prindërit janë edukatorët e parë të fëmijëve të tyre. Programi ynë e përfshin këtë filozofi dhe ka zhvilluar programe edukimi të zgjeruara, inovative për prindërit, të cilat nxisin prindërit/kujdestarët/familjet si partnerë në vendimmarrje, ndarjen e qeverisjes dhe rezultatetve të aktiviteteve në gatishmërinë për në shkollë

Standardet e performancës të Programit “Head Start” ofrojnë të gjitha mundësitë për prindërit, kujdestarët dhe pjestarët e familjes të fëmijëve që vazhdojnë programin, për të marrë pjesë në një varg rrugësh të programit, si vullnetarë, vrojtes dhe të punësuar me pagesë.

Ky program i financuar nga federali kërkon të shoqërohet me 25% nga burime jo-federale. Orët e vullnetarizmit të prindërve janë kërkesë e rëndësishme, si pjesë e plotësimit shoqërues nga burimet e tjera.

Përfshirja dhe angazhimi i prindërve/familjeve në programin “Head Start” është një nga aspektet më të rëndësishme të kornizës së Angazhimit të Prindërve, Familjes dhe Komunitetit. Angazhimi i Familjes gjithashtu fokusohet në edukimin e prindërve, duke i referuar familjet në agjensi të tilla shërbimesh si strehimi, literaturë financiare dhe siguri i ushqimit dhe veshjeve në raste urgjente.

Programet e Prindërimit që ne ofrojmë...

- “Incredible Years”
- “Ready Rosie”
- “Understanding Children”



KODI I SJELLJES SË PRINDIT



Familjet nxiten të planifikojnë kohën më të përshtatshme për ata, që të jenë vullnetar. Të gjithë vullnetarët (prindërit, pjestarët e familjes, organizatat komunitare) të cilët vazhdimisht angazhohen në aktivitetet e klasave, kërkohet të kenë çertifikatën e pastërtisë në dosjen e vullnetarit. Këtu përfshihen:

- o "A Child Abuse Clearance"
- o "Act 126 Child Abuse Training Certificate"
- o "Criminal Background Check"
- o "Current TB Test Result"

Kodi i Sjelljes

Kur punojnë si vullnetar në klasë, ose në aktivitetet e programit "Head Start", të rriturit duhet të jenë shëmbëlltyrë e shëmbullit të mirë. Rregullat e "Head Start" kërkojnë që çdo program të shërbehet në mjedise të sigurta, ku çdonjëri tëndjehet mirë dhe i mbrojtur. Kështu që është e nevojshme të miratojmë sisteme dhe politika që garantojnë mirëqenien e çdo fëmije, familje dhe personelit të programit.

Ju lutemi shmanguni nga përfshirja në shëmbujt e mëposhtëm të sjelljes negative:

- Ndërhyrja në personelin e menaxhimit të fëmijëve;

- Fëmijët nuk mund të quajmë, ose të jenë subjekte të dënimit trupor;
- Shmangia nga fyerjet dhe gjestet e turpshme;
- Përdorimi i drogës, ose pijeve alkoolike, ndërsa janë në, ose pranë mjediseve të "Head Start"; (kjo përfshin edhe përdorimin e tyre më përpara se të futen në mjedise të programit "Head Start").
- **JU LUTEMI** firmoseni dhe kthejeni kodin e sjelljes të mësuesit të fëmijës tuaj.

Kujtohuni ndërsa jeni Vullnetar....

- Ejani dhe përgatituni të angazhoheni në aktivitetet nën udhëzimet e personelit të klasës;
- Të gjitha aktivitetet, ose detyrat janë të rëndësishme. Sa më shumë mbështetje që jepni, aq më shumë ju dhe fëmijët e tjerë do të fitojnë nga përvoja e "Head Start".
- Dokumentoni orët tuaja të vullnetarizmit dhe plotësoni Formularin e Kohëshënuesit të Vullnetarit, çdo herë që ju jeni vullnetar në qendër, ose aktivitetet e programit.

SHENIM:

Programi "The Head Start" rezervon të drejtën të kufizojë çdo prind/kujdestar, ose pjestar të familjes, që të futen në mjediset e "Head Start", nëse ai/ajo sillet në mënyrë që është agresive, kërcënuese, ose jo e

respektueshme për ndonjë fëmijë, prind, ose pjestar të personelit të programit.

Procedurat e Ankimit të Prindërve dhe Komunitetit

Një ankim nga komuniteti është një ankesë me shkrim, e kryer nga një prind i "Head Start", ose pjestar i komunitetit, që ka të bëjë me me shqetësimet dhe shkeljet e rregullave, ose politikës të "Head Start", nga një përfaqësues, ose i punësuar nga ky program parashkollor.

Për Paraqitjen e një Ankimi

- Të gjitha ankimet/shqetësimet duhet të paraqiten me shkrim te Këshilli i Politikës të Programit Parashkollor "Head Start" brend a5 ditëve nga incidenti i supozuar.
- Shqetësimi duhet të jetë specifik sipas natyrës së incidentit, rregullores dhe politikës/procedurës që prek.
- Ankesat/shqetësimet ku pretendohet për aktivitet kriminal, që pengon sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve dhe personelit **DUHET** duhet të raportohen në agjensitë e zbatimit të ligjit, për veprim të menjëhershëm.
- Përpjekjet duhet të bëhen që të zgjidhen këto ankesa në rradhë të parë në Qendër.



Ne fokusohemi te prindërit/kujdestarët sepse ata janë:

- Mësuesit e parë dhe edukatorë gjatë gjithë jetës të fëmijëve të tyre
- Përgjegjës për mirëqënien e famijes/fëmijëve të tyre
- Partnerë kryesorë në procesin e vendimmarrjes së programit

Programi ynë varet nga prindërit/kujdestarët si vullnetarë. Ndiurma dhe asistena juaj është e nevojshme në shumë rrugë të programit. Ka shumë mundësi për ju që të përfshihen në synimet e Gatisshmërisë për në Shkollë dhe Rezultatet e fëmijës tuaj.

Më poshtë janë disa ide për vullnetarët:

Në klasë

- Asiston në klasë nën udhëzimet e mësuesit
- Punon me grupe të vogla me fëmijët në aktivitete/projekte speciale
- Luan me fëmijët lojra edukative dhe sociale
- Lexon tregime në grup të vogël, ose klasë
- Përgatit materialet për artin dhe projektet e tjera në klasë
- Shoqëron në ekskursione
- Demonstron dhe mëson zeje të veçanta, ose veprimtari me klasën
- Asiston në kohën e ushqyerjes (shërbim ushqimi, larjen e duarve etj.)
- Asiston në planifikimin e mësimit

- Merr pjesë në vizitat në shtëpi dhe takimet prind/mësues

Në Shtëpi

- Lexoni për fëmijën dhe përfshihen në aktivitete/nisma në shkrim-lexim.
- Angazhon fëmijën në veprimtari që përforcojnë kurrikulën e klasës
- Përgatit materialet për në klasë.
- Rekrutoni familjet e tjera për regjistrimet e mundëshme, etj.

Udhëheqësia dhe Mbrojtja

- Ndjek takimet mujore të komitetit të prindërve në qendër
- Shërben si i zgjedhur në komitetin e prindërve
- Shërben si përfaqësues i qendrës në Këshillin e Politikës (grup nga gjithë qyteti)

- ❑ Merr pjesë në takimet e grupeve këshilluese të shërbimit të zonës
- ❑ Asiston dhe merr pjesë në aktivitetet për prindërit (seminare/trajnime, kualifikim dhe vazhdim i mundësive edukative, etj).
- ❑ Merr pjesë në mbledhjen e autorizuar të fondeve, që çon në rritjen e fondeve për pasurimin dhe zgjerimin e përvojës mësimore për fëmijët dhe familjet (p.sh vizita në muzeume, kopësht zoologjik, teatër, etj).
- ❑ **Agjensitë partnere të Kujdesit për Fëmijët, kanë politikën e tyre të fondeve.**
- ❑ Merr pjesë në veprimtaritë lokale, shtetërore dhe federale për mirëqënien e fëmijëve dhe familjeve.

Vullnetarët

UDHËZIME TË DOBISHME PËR VULLNETARET

Bëni

- ✚ Njihuni me procedurat e klasës
- ✚ Mësoni dhe përdorni emrat e fëmijëve
 - ✚ I tregoni fëmijëve emrin tuaj dhe i nxitni ata t'a përdorin
- ✚ Jepni shembullin e mirë duke folur pastër
- ✚ Tregoni sjellje të mira- përdorni fjalë të tilla si “faleminderit” dhe “ju lutem”
- ✚ I lavdëroni fëmijët për sjelljet e mira, kuriozitetin dhe përgjigjet e duhura
- ✚ Dëgjoni çfarë kanë fëmijët për të thënë.
- ✚ Respektoni diferencat e njëri-tjetrit, mos harroni që çdo person reflekton kultura dhe vlera të ndryshme
- ✚ Mbështeteni nevojat emocionale të fëmijëve duke ndihmuar që ata të ndjehen të sigurtë
- ✚ Rritni vetëbesimin e fëmijëve me thënie të tilla si....
 - o “You did a good job putting all the books away”
 - o “You have really learned a lot”
 - o “You were a good listener when I read the story”
- ✚ Ndihmoni fëmijët që të flasin për problemet e tyre, kështu që ata do të mësojnë rrugë pozitive për zgjidhjen e konflikteve
- ✚ Jepni opinionin tuaj mësuesit për progresin e fëmijëve në aktivitetin që zhvillon bashkërisht
- ✚ Respektoni konfidencën e prindit të fëmijës për shmangien e problemeve ligjore dhe/ose padive. Firmosni formularin e konfidencialitetit
- ✚ Prisni që fëmijët t'ju trajtojnë si mësues, veproni si i tillë, pyesni mësuesin për udhëzime



Mos

- ✚ Hani, ose pini asgjë para fëmijëve, që nuk janë në menunë e tyre
- ✚ Flitni negativisht te ndonjëri për fëmijët dhe prindërit e tjerë
- ✚ Flitni për fëmijët e të tjerëve me asnjëri, përveç mësuesit kur është e nevojshme
- ✚ Shani, bërtitni, përtypni çimçakiz, ose pymosni duhan, në prezencë të fëmijëve
- ✚ Frikësoni fëmijët duke i kërcënuar ata me shuplaka, me gogola, etj. Fëmijët kanë nevojë të ndjehen të sigurtë në praninë tuaj
- ✚ Sikletosni fëmijët, ose të përpiqeni që të ndjehen keq, me shprehje “ti je i keq”, “je si mace e ngordhur” (“you’re bad”, “scaredy cat”)
- ✚ Qëlloni, ose lejoni fëmijët të lëndojnë njeri- tjetrin



F.F.A.M.I.L.Y GROUP Angazhimi i Burrave

Atësia/Nisma për Përfshirjen e Burrit

Angazhimi i Prindit dhe Familjes
Atësia/Nisma për Përfshirjen e Burrit



Vizitë e Prindit/Fëmijës në “Fox Chase Farm”



Grupi i Burrave në “Temple University – Symphony of A Broken Orchestra



FFAMILY Park Safety Seminar- Fairmount Park

F.F.A.M.I.L.Y.

ETËRIT & FEMRAT PERKRAHIN PERFSHIRJEN E BURRIT NE JETET E TE RINJVE

“Një Bashkësi e Vëllezërve dhe Motrave bëjnë diferencën në jetët e të rinjve”

Grupi “The F.A.M.I.L.Y. Group” ka filluar organizimin në vitin 1992, si një nënkomitetet i Këshillit të Politikës së programit Parashkollor “Head Start”, në kujtim të të ndjerit Eric Bradwell, qëllimi i të cilit ishte të rriste pjesëmarrjen e burrave në program. Ai vdiq tragjikisht në një aksident automobilistik në dimër të 1991. Kjo nismë përfshin etërit, gjyshërit, xhaxhallarët, vëllezërit dhe meshkujve të tjerë të komunitetit, të cilët kanë preokupim mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve në komunitetin e Filadelfias. Grupi ka shtuar në sukseset e tij: videot e paraqitura për trajnime, në programin e drejtimit, Seritë e “**Linking Our Voices**”, dhe “**Building Blocks**”, në fazat e përfshirjes/angazhimit të etërve, të dyja u porositën nga Zyra Kombëtare e “Head Start”. Përpjekje të tjera bashkëpunuese përfshijnë zhvillimin e “A Resource Book for Male Involvement in Head Start” me “Temple University”. Paraqitja dhe të folurit në konferenca në shkallë lokale, shtetërore dhe kombëtare.

Grupi ka konceptualizuar rëndësinë e angazhimit të burrave dhe grave në jetët e fëmijëve dhe që “It Takes a Village to Raise a Child”, dhe në vitin 2009, shtuan zurtasht një “F” të dytë, që të lëviznin më përpara vizionin drejt një qasje tërësore e familjes. Takimet e grupit mbahen çdo muaj, ku sesionet përfshijnë formimin e aftësisë, ndërtimin e strategjive dhe koncepteve, edukimin prindëror, zhvillimin e lidhësive dhe ndërgjegjësimin/fuqizimin e avokatisë

Grupi është i angazhuar në promovimin e zhvillimit të shkrim-leximit nëpërmjet programit dhe ka zhvilluar e koordinuar disa aktivitete. Këto përfshijnë:

- Lexo gjatë gjithë fëmijërisë së Herëshme – lexoni bashkë me fëmijët në klasat e parashkollorit
- ☐ Shkrimi dhe Publikimi i dy librave
 - **My Best Friends Only Speaks With His Hands** – shkruar nga prindër burra dhe gra
 - **“Pop-Pop’s Sleeping”** – shkruar nga vullnetarë etër/burra

Mundësitë për Punësim

MUNDËSITË PËR PUNËSIM PËR FAMILJET “HEAD START”

Programi Parashkollor “Head Start” ofron shumë mundësi punësimi për prindërit/kujdestarët e fëmijëve që janë aktualisht të regjistruar, ose që janë pjesëmarrës në program brenda pesë (5) viteve nga regjistrimi. Këto pozicione mund të jenë profesionale, ose para-profesionale, sipas kërkesave të kualifikimit.

Të gjithë aplikantët e punësimit për kohë të plotë, të pjesëshme, ose ditore duhet të dërgojnë përpara punësimit evidenca të dokumentacionit të mëposhtëm:

- o “A Child Abuse Clearance”
- o “PA Act 126 Child Abuse Training Certificate”
- o “FBI Fingerprints”
- o “Criminal Background Check”
- o “Current TB Test Result”
- o “Current Physical Examination”
- o “High School Diploma or GED”
- o “Highly Qualified Exam”
- o “Child Development Associate Credential (CDA)*”

KLASIFIKIMI I PUNËVE

Para-Profesional

- o Teacher Assistant*
- o Family Services Field Representative
- o Parent Involvement Coordinator
- o Parent Involvement Assistant
- o Nutrition Field Representative
- o Food Service Worker
- o Maintenance Support
- o Customer Service Liaison



Pozicione me kohë të Pjesëshme, Ditore

- o Zëvendësues i asistentit të mësuesit (Substitute Teacher Assistant)
 - o Zëvendësues i Ndihnësit të Drekës (DUHET të regjistroheni nëpërmjet “Kelly Education Staffing” në www.teachkidsnow.com)
 - o Asistent i Nevojave Speciale
- Për aplikim kontaktoni :Melody Hidelbird
në: 215-400-6216

Zëvendësues

- o Asistent i Mësuesit (Teacher Assistant)
- o Punonjës i Shërbimit të Ushqimit (Food Service Worker)

Aplikantët duhet të kenë përshtatshmërinë të udhëtojnë në qendrat e tjera sipas nevojave.

Për informacion dhe procesin e aplikimit, kontaktoni “ Early Childhood Education Office - Head Start” në 215-400-4270.

Shënime

The School District of Philadelphia
Office of Early Childhood Education Pre K-3



Making a World of Difference



Buletini është Konceptuar e Plotësuar nga

Denota E. Watson

Koordinatorë për Angazhimin e Prindit

Rishikuar: Gusht 2014

Përditësuar: Korrik 2015

Përditësuar: Korrik 2016

Përditësuar: Gusht 2017

Përditësuar: Prill 2018

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
EDUCATION CENTER
440 NORTH BROAD STREET
PHILADELPHIA, PA 19130

OFFICE OF EARLY CHILDHOOD EDUCATION
PREKINDERGARTEN HEAD START OFFICE
SUITE 170
PHONE: 215-400-4270

